



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria- Vlada - Government*

*Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health*

**Departamenti Shëndetësor i Burgje**

Në mbështetje të nenit 17, artikullit 6 (6.1; 6.2; 6.3; 6.4), nenit 35, artikullit 1, 2, dhe 3 të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L-156 ; ne mbështetjeje te nenit 4, artikujt 1, 2, dhe 3; nenit 8, artikujt 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, neni 11, artikulli 1 të Udhëzimit Administrativ mbi funksionimin e shërbimeve shëndetësorë të burgjeve Nr 05/2014 i QRK-se, si dhe bazuar ne UA Nr. 09/2014, UA Nr. 03/2007 te Ministrisë se Shëndetësisë, Drejtori i DShB, përcakton specifikat për:

**HAPËSIRAT, KUSHTET DHE PAJISJET MEDICINALE TË  
INSTITUCIONEVE SHËNDETËSORE NË BURGJE**

**Qëllimi**

Me këtë akt përcakton kushtet e përgjithshme dhe specifike për hapësirat, kushtet dhe pajisjet e nevojshme medicinale për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në institucionet shëndetësor te burgjeve.

**Fushëveprimi**

Këto specifika janë obligativ për te gjitha institucionet shëndetësor te burgjeve. Te gjitha këto kriteret duhet te plotësohen ne periudhën prej 12 deri ne 24 muaj<sup>1</sup>. Përgjegjëse për implementimin e këtyre specifikave janë MD dhe MSh bazuar ne nenin 4, artikulli 2 (2.3; 2.6) të Udhëzimit Administrativ mbi funksionimin e shërbimeve shëndetësorë të burgjeve Nr 05/2014 i QRK-së.

---

<sup>1</sup> Përfshirë bene Institucioni për trajtimin e personave me nevoja te veçanta i cili duhet te themelohet sipas Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, (neni 17 artikulli 6);

## Institucionet shëndetësore në burgje

1. Institucionet shëndetësore ne burgje, sipas Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësi, (neni 17 artikulli 6), janë:

2.1. **Ambulanca e burgut;** Ambulanca e burgut përbehet nga këto elemente:

- 2.1.1. Ambulanca specialistike sipas UA 09/2014 te MSh-se.
- 2.1.2. Ambulanca specialistike e Mjekësisë Familjare, sipas specifikave te burgut dhe UA/09/2014<sup>2</sup>.
- 2.1.3. Ambulancës stomatologjike<sup>3</sup>
- 2.1.4. Shërbimit psikologjik ose psikologjik klinik.
- 2.1.5. Shërbimit konsultativ psikiatrik.
- 2.1.6. Shërbimit farmaceutik doracak specifik.
- 2.1.7. Shërbimit laboratorik biokimik dhe hematologjik specifik bazik.

2.2. **Stacionari i burgut;** Stacionari i burgut përbehet nga këto elemente:

- 2.2.1. Ambulancën e burgut sipas specifikave (2.1).
- 2.2.2. Shërbimi konsultativ kardiologjik
- 2.2.3. Shërbimi konsultativ ortopedik\*
- 2.2.4. Shërbimi konsultativ për Otorinolaringologji – ORL\*
- 2.2.5. Shërbimi konsultativ internistik pulmologjik\*
- 2.2.6. Shërbimi konsultativ radiologjik\*
- 2.2.7. Shërbimi konsultativ urologjik \*
- 2.2.8. Shërbimi fiziatrik dhe fizioterapeutik\*
- 2.2.9. Shërbimi i oftalmologjisë \*
- 2.2.10. Shërbimi konsultativ i kirurgjisë\*
- 2.2.11. Shërbimi bazik i urgjencës
- 2.2.12. Shërbimet e tjera kryhen ne dhoma te sigurta ne Spitale dhe QKUK<sup>4</sup>

2.3. **Institucioni shëndetësor për trajtimin e personave me nevoja të veçanta<sup>5</sup>;** përmban këto njësi:

- 2.3.1. Njësia për trajtimin e personave me nevoja te veçanta (10);
- 2.3.2. Njësia gerontologjike (20),
- 2.3.3. Njësia për trajtim te shtuar mental (15),
- 2.3.4. Njësia për trajtimin e personave me sëmundje te varësisë, (25):
- 2.3.5. Njësia për trajtimin e sëmundjeve kronike (25)

2.4. **Institucioni shëndetësor për kujdesin e nënës dhe fëmijut dhe për te mitur,** përbehet nga këto elemente:

- 2.4.1. Ambulanca specialistike sipas UA 09/2014 te MSh-se.
- 2.4.2. Ambulanca specialistike e Mjekësisë Familjare, sipas specifikave te burgut dhe UA/09/2014.
- 2.4.3. Ambulanca specialistike gjinekologjike specifike për ambulancën e burgut<sup>6</sup>

<sup>2</sup> Specifikat janë te precizuara ne këtë dokument.

<sup>3</sup> Ne ato NjShB ku ka kushte, indikacione dhe hapësirë.

<sup>4</sup> Shërbimet nga 2.2.3 deri ne 2.2.10 kryhen vetëm ne Stacionarin e Dubraves,

<sup>5</sup> Ky institucion duhet te ndërtohet dhe nuk mund te realizohet ne përdihen e parapare.

- 2.4.4. Ambulanca specialitike pediatrike specifike për ambulancën e burgut<sup>7</sup>
- 2.4.5. Ambulancës stomatologjike
- 2.4.6. Shërbimit psikologjik ose psikologjik klinik.
- 2.4.7. Shërbimit konsultativ psikiatrik.
- 2.4.8. Shërbimit farmaceutik doracak specifik.
- 2.4.9. Shërbimit laboratorik biokimik dhe hematologjik specifik bazik.

### **Kushtet e përgjithshme**

1. Institucioni shëndetësor të burgjeve duhet të plotësojë këto kushte të përgjithshme.
  - 1.1 Të sigurojë qasje të lehtë për personat me aftësi të kufizuara;
  - 1.2 Lartësia e mureve të objektit duhet të jetë së paku 260 cm;
  - 1.3 Duhet të ketë ngrohje, në përputhje me standardet teknike dhe ekologjike;
  - 1.4 Duhet të ketë pritore për pacientë prej së paku 9 m<sup>2</sup>;
  - 1.5 Institucionet shëndetësore me një njësi organizative duhet të kenë së paku një nyje sanitare;
  - 1.6 Institucionet shëndetësore me dy ose më shumë njësi organizative, që punojnë njëkohësisht, duhet të kenë së paku dy nyje sanitare;
  - 1.7 Institucioni shëndetësor me dy njësi organizative duhet të ketë hapësirën e pritores prej së paku 12 m<sup>2</sup>;
  - 1.8 Laboratorët duhet të posedojnë së paku dy nyje sanitare;
  - 1.9 Në ordinancë dhe nyje sanitare duhet të ketë lavaman me ujë të ngrohtë, sapun dhe mjete për tharjen e duarve
  - 1.10 Dyshemeja duhet të jetë nga materiali i cili mundëson dezinfektimin dhe pastrimin e lehtë dhe të shpejtë;
  - 1.11 Dyert dhe muret e hapësirave, duhet të jenë të rrafshëta, të lëmuara dhe rezistente ndaj pastrimit të shpeshtë dhe me specifika të sigurisë, aty ku eshet e mundur<sup>8</sup>;
  - 1.12 Dera e hyrjes në institucion duhet të ketë gjerësi së paku 110cm;
  - 1.13 Dyert tjera duhet të kenë gjerësi prej 90-110cm;
  - 1.14 Dyert nuk duhet të kenë prag;
  - 1.15 Të plotëson kushtet e parapara sipas rregullativës për kyçje në rrjetin e ujës-jellësit, kanalizimit, rrymës elektrike dhe mbrojtje kundër zjarrit;
  - 1.16 Të ketë burim alternativ të energjisë elektrike(UPS, agregat)\*;
    - 1.17 Të ketë burim alternativ të ujit (rezervuar) ose të sigurohet në mënyra të tjera sasia e nevojshme e ujit të pijshëm për ushtrimin e papenguar të veprimtarisë shëndetësore;
  - 1.18 Të posedon pajisje të teknologjisë informative;
  - 1.19 Hapësira e punës në institucion shëndetësor duhet të ketë ndriçim dhe ventilim të mjaftueshëm;
  - 1.20 Për hapësirat me ndriçim të pamjaftueshëm duhet siguruar ndriçim shtesë:

<sup>6</sup> Ky shërbim kryhet vetëm në ato burgje ku ka femra, nëna me fëmijë.

<sup>7</sup> Ky shërbim kryhet vetëm në ato burgje ku ka femra, nëna me fëmijë dhe të mitur.

<sup>8</sup> Dyert me xhama në pjesën e sipërme (1/3).

- 1.20.1.Në hapësirat e ambulancave prej 250-500 lluksa;
- 1.20.2.Në vendet e tjera të punës prej 70-100 lluksa;
- 1.20.3.Në korridore dhe shkallë 40 lluksa
- 1.21 Dritaret e institucionit shëndetësor duhet të jenë të vendosura ashtu që të depërtojë drita dhe të kenë qasje të lehtë për pastrim
- 1.22 Kompletet për anti-shok terapi dhe produktet medicinale sipas llojit të veprimtarisë, në institucionet shëndetësore ku lejohet mbajtja e tyre, duhet të jenë të vendosura dhe të ruhen në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi;
- 1.23 Preparatet dhe kemikaliet lehtë të ndezshme duhet të ruhen në ambalazh origjinal në hapësirë të mbyllur apo dollap të veçantë sipas dispozitave ligjore në fuqi;
- 1.24 Hapësirat e institucionit shëndetësor nuk mund të shfrytëzohen për banim apo destinim tjetër.
- 1.25 Institucionet shëndetësore gjatë orarit të punës duhet të kenë prezent stafin përkatës shëndetësor.
- 1.26 Ambulanca e burgut duhet të ketë minimum, këto hapësira sipas standardeve të lartcekura:
  - 1.26.1. Një hapësirë për pritore
  - 1.26.2. Një hapësirë për vizite mjekësore - dhoma e mjekut;
  - 1.26.3. Dhoma për intervenime, e infermiereve;
  - 1.26.4. Dhoma për dentistin;
  - 1.26.5. Dhoma për psikologun;
  - 1.26.6. Zyre për kartotekë dhe të dhëna shëndetësore;
  - 1.26.7. Depo e barërave
  - 1.26.8. Depo për material të zyrës dhe atë higjienik
  - 1.26.9. Zhveshtore

### **Kushtet specifike**

Institucioni shëndetësor në të cilin do të ushtrohet veprimtaria shëndetësore duhet të plotësojë kushtet specifike sipas llojit të institucionit shëndetësor, specifikeve të burgosurve, specifikeve të kapacitetit të burgut dhe destinacionit të tij.

## **I. AMBULANCA E BURGUT**

1.0.Ambulanca e burgut, përpos kushteve të përgjithshme të këtij vendimi, duhet të plotësojë edhe kushtet në vijim:

### **1.1 Hapësira:**

- 1.1.1 Hapësira e ambulancës duhet të ketë sipërfaqe prej së paku 12m<sup>2</sup>.
- 1.1.2 Pritorja prej së paku 9m<sup>2</sup>;
- 1.1.3 Hapësirën për kompjuter dhe dokumentacion mjekësor;

- 1.1.4 Ne afërsi të ambulancës ku trajtohen pacientët me sëmundje ngjitëse të diagnostikuar, duhet siguruar edhe hapësirën për izolim prej së paku 9m<sup>2</sup>;
- 1.1.5 Ambulanca ku kryhen intervenime të vogla kirurgjike me anestezion lokal është e nevojshme të siguron edhe hapësirë të veçantë prej së paku 12m<sup>2</sup>.
- 1.1.6 Hapësirat duhet te plotësojnë kushtet e nenit 3, dhe artikullit 1.26;

## **1.2 Inventar:**

- 1.2.1 Tavolina e punës për mjekun;
- 1.2.2 Tavolina e punës për infermiere
- 1.2.3 Kompjuter;
- 1.2.4 Karriget për mjekun dhe infermierën, me mekanizmin e përcaktimit të lartësisë, rrotulluese dhe lëvizëse;
- 1.2.5 Karriga pa mbështetëse për pacientin;
- 1.2.6 Varëse për rroba;
- 1.2.7 Shtrat për ekzaminim të pacientit;
- 1.2.8 Paravane;
- 1.2.9 Dollapin për barëra dhe instrumente;
- 1.2.10 Tavolinën për instrumente;
- 1.2.11 Shportë për mbeturina medicinale si dhe shportë për mbeturina tjera, e cila pjesën e brendshme e ka metalike dhe hapet me shtypje të pedales me këmbë.

## **1.3 Pajisja bazike të ambulancës së burgut**

- 1.3.1 Termometër (se paku 2 copë);
- 1.3.2 Stetoskop;
- 1.3.3 Matës të shtypjes së gjakut;
- 1.3.4 Shpatulla për një përdorim;
- 1.3.5 Dorëza për një përdorim;
- 1.3.6 Fasha;
- 1.3.7 Kompleti i antishok-terapisë;
- 1.3.8 Peshore;
- 1.3.9 Matës të gjatësisë;
- 1.3.10 Enë metalike;
- 1.3.11 Enët me kapak për instrumente;
- 1.3.12 Enën me kapak për tamponë;
- 1.3.13 Veshkore;
- 1.3.14 Negatoskop;
- 1.3.15 Aparat për oksigjen;
- 1.3.16 Bombol me oksigjen;
- 1.3.17 Bombol rezervë të oksigjenit;
- 1.3.18 Dritë tavoline;
- 1.3.19 Thjerrzën zmadhuese;
- 1.3.20 Llampë të dorës me bateri;
- 1.3.21 Glikometer;
- 1.3.22 Lidhësen e Esmarch-ut;
- 1.3.23 Kapësin e instrumenteve dhe enën për mbajtjen e tij;
- 1.3.24 Telefoni;

- 1.3.25 EKG;
- 1.3.26 Defribilator;
- 1.3.27 Pulsoksimetër;
- 1.3.28 Peakflowmetër;
- 1.3.29 Otokopi;
- 1.3.30 Pasqyrë e ballit;
- 1.3.31 Oftalmoskop;
- 1.3.32 Tabela për kontrollin e shikimit;
- 1.3.33 Sterilizator të thatë
- 1.3.34 Frigorifer
- 1.3.35 Mbajtës infuzioni
- 1.3.36 Hapësin e gojës
- 1.3.37 Mjete për mobilizim të përkohshëm
- 1.3.38 Çantën e mjekut me mjete dhe barna të nevojshme për intervenime.

#### **1.4 Pajisja shtese te ambulancës se burgut:**

- 1.4.1 Laringoskop\*
- 1.4.2 Spekulumi për zgavrat e hundës\*
- 1.4.3 Shiringën apo aparatën për shpërlarjen e veshëve\*
- 1.4.4 Fetoskopin\*
- 1.4.5 Çekanin për reflekse\*
- 1.4.6 Komplet të uro-kateterave me dimensione të ndryshme për një përdorim\*
- 1.4.7 Pajisje për marrjen e materialit për analiza hematologjike, biokimike dhe mikrobiologjike me sistem të mbyllur\*
- 1.4.8 Hapësin e gojës\*
- 1.4.9 Mjete për mobilizim të përkohshëm\*

#### **1.5. Shërbimi Stomatologjik**

Shërbimi Stomatologjik është pjese përbërës e ambulancës se burgut ne ato burgje ku ka shërbim stomatologjik dhe duhet të plotësoj kushtet në vijim:

##### **1.1 Hapësira:**

- 1.1.1 Hapësira prej 12m<sup>2</sup>, ku kontrollohen dhe trajtohen pacientët është e paraparë vetëm për një karrige stomatologjike dhe aparaturë tjetër përcjellëse;
- 1.1.2 Hapësira për 2 karriga stomatologjike në një ambulancë duhet të jetë më e madhësi 20m<sup>2</sup>;
- 1.1.3 Nëse hapësira ku gjendet karriga stomatologjike ka më shumë se 20m<sup>2</sup>, atëherë nuk nevojitet hapësirë tjetër për përgatitje dhe dokumentacion mjekësor;

##### **1.2 Pajisje dhe inventar:**

- 1.2.1 Njësi dentare me karrige stomatologjike;
- 1.2.2 Karrika e terapeutit;
- 1.2.3 Burim artificial të dritës për ekzaminim;
- 1.2.4 Turbina;

- 1.2.5 Mikromotorët;
- 1.2.6 Kundërkandi;
- 1.2.7 Aspiratori;
- 1.2.8 Kompresori;
- 1.2.9 Kavitroni;
- 1.2.10 Helioluksi apo heliomati;
- 1.2.11 Sterilizatori (me ajër të nxehtë ose autoklavë);
- 1.2.12 Përzierësi i amalgamit;
- 1.2.13 Tavolina lëvizëse për instrumente;
- 1.2.14 Ormani për instrumente dhe materialin tjetër;
- 1.2.15 Tavolina për shkrim.

### 1.3 **Instrumentet:**

- 1.3.1 Mbajtës të pasqyrave me pasqyrë stomatologjike;
- 1.3.2 Sonda;
- 1.3.3 Pinceta të lakuara;
- 1.3.4 Pinceta të drejta;
- 1.3.5 Mbajtës dhe shtypës të amalgamit;
- 1.3.6 Instrumente për modelimin e mbushjeve;
- 1.3.7 Ekskavator;
- 1.3.8 Sonda paradontologjike;
- 1.3.9 Shpatulla për përzierjen e cementit;
- 1.3.10 Shpatulla plastike për përzierje;
- 1.3.11 Llamba;
- 1.3.12 Kova e gomës;
- 1.3.13 Lopatëza për përzierje;
- 1.3.14 Pllakëza të qelqit;
- 1.3.15 Kireta universale;
- 1.3.16 Dara për nxjerrjen e inçizivëve të sipërm;
- 1.3.17 Dara për nxjerrjen e premolarëve të sipërm;
- 1.3.18 Dara për nxjerrjen e molarëve të sipërm të majtë;
- 1.3.19 Dara për nxjerrjen e molarëve të sipërm të djathtë;
- 1.3.20 Dara për rrënjët e nofullës së sipërme;
- 1.3.21 Dara për nxjerrjen e inçizivëve të poshtëm;
- 1.3.22 Dara për nxjerrjen e premolarëve të poshtëm;
- 1.3.23 Dara për nxjerrjen e molarëve të poshtëm;
- 1.3.24 Leva sipas Bajnit;
- 1.3.25 Leva për rrënjë të nofullës së poshtme;
- 1.3.26 Pean;
- 1.3.27 Mbajtës të gjilpërës kanalikulare;
- 1.3.28 Daullen metalike për gaza sterile;
- 1.3.29 Kompletin e antishok terapisë;
- 1.3.30 Pajisjet për tamponadë dhe ndaljen e gjakderdhjes;
- 1.3.31 Instrumentet për shërimin e kanalit të rrënjëve (endobox);
- 1.3.32 Respiratorin manual;
- 1.3.33 Lugë për marrjen e masës për nofull të sipërme;

- 1.3.34 Lugë për marrjen e masës për nofull të poshtme;
- 1.3.35 Mbajtës të matricave;
- 1.3.36 Enët për instrumente të papastërta;
- 1.3.37 Ena për mbajtjen e vatës;
- 1.3.38 Enët për mbajtjen e gjilpërave për konservativ (pllaka e Petrit);
- 1.3.39 Ena për vendosjen e frezave;
- 1.3.40 Ena apo vendi për vendosjen e vaterollnave.
- 1.3.41 Lista shtese ne listën e barërave<sup>9</sup>

## **1.6. SHËRBIMI KONSULTATIV I PSIKIATRISË**

**Pajisje:** Nuk kërkon pajisje shtese nga ajo e ambulancës specialistike.

## **1.7. SHËRBIMI SPECIALISTIK I PSIKOLOGJISË DHE PSIKOLOGJISË KLINIKE**

**Pajisje:** Nuk kërkon pajisje shtese nga ajo e ambulancës specialistike.

## **1.8. SHËRBIMIT FARMACEUTIK DORACAK, SPECIFIK**

**Pajisje:** Procedurat, hapësira dhe lista janë përcaktuar me listën e barërave dhe materialit shëndetësore dhe ne procedurat e punës.

## **1.9. SHËRBIMIT LABORATORIK BIOKIMIK DHE HEMATOLOGJIK SPECIFIK**

**Pajisje:** Procedurat, hapësira dhe lisat e pajisjeve e produkteve janë përcaktuar ne listën e barërave dhe materialit shëndetësor ne pjesën e laboratorit.

# **II. AMBULANCA E BURGUT PËR NËNËN, FËMIUN DHE TE MITUR**

## **1.0.AMBULANCA E BURGUT PËR TË MITUR**

1. Ambulanca e burgut për te mitur, përpos kushteve specifike te Ambulancës se burgut duhet të ketë edhe këto pajisje si në vijim:

### **1.1.Pajisje:**

- 1.1.1. Mansheta dimensionesh të ndryshme për matje të TA;
- 1.1.2. “Baby” sisteme për dhënien e infuzioneve;
- 1.1.3. Aspirator<sup>10</sup>;
- 1.1.4. Kompletin e tubusave për intubim për fëmijë;

<sup>9</sup> Kjo listë i është bashkangjitur listës se pajisjeve qe përpos këtyre pajisjeve ka dhe pajisje dhe material shtesë

<sup>10</sup>Është edhe te Pajisjet e përgjithshme te Ambulancës se burgut



- 1.1.5. Komplet për otorinoskopi<sup>11</sup>;
- 1.1.6. Komplet për oftalmoskop<sup>12</sup>;
- 1.1.7. Llamba baktericide UV;
- 1.1.8. Nebulizator;
- 1.1.9. Spekulum për zgavrat e hundës<sup>13</sup>;

## **2.0.AMBULANCA E BURGUT PËR NËNËN DHE FËMIUN**

2.1.Ambulanca e burgut për nenën dhe femiun përpos kushteve specifike të Ambulancës së burgut, duhet të ketë edhe këto pajisje dhe inventar si në vijim:

### **2.2.Pajisje dhe inventar:**

- 2.2.1. Tavolina me ngrohës për ekzaminim të fëmijës;
- 2.2.2. Stetoskopin e përshtatshëm për fëmijë;
- 2.2.3. Mansheta dimensionesh të ndryshme për matje të TA;
- 2.2.4. Peshorja klasike dhe me gotatë për matjen e peshës së foshnjave dhe gjatësisë së tyre;
- 2.2.5. “Baby” sisteme për dhënien e infuzioneve;
- 2.2.6. Aspirator;
- 2.2.7. Kompletin e tubusave për intubim për fëmijë;
- 2.2.8. Komplet për otorinoskopi;
- 2.2.9. Komplet për oftalmoskop;
- 2.2.10. Llamba baktericide UV;
- 2.2.11. Nebulizator;
- 2.2.12. Laringoskop<sup>14</sup>;
- 2.2.13. Spekulum për zgavrat e hundës;
- 2.2.14. Irigatori\*
- 2.2.15. Pelvimetri\*
- 2.2.16. Spekulumet vaginale të ndryshme\*
- 2.2.17. Danat për Cerviks dhe Uterus\*
- 2.2.18. Sterilizator të thatë<sup>15</sup>\*
- 2.2.19. Kompletin me instrumente kirurgjike për kryerjen e intervenimeve të vogla kirurgjike-gjinekologjike, vetëm nën anestezion lokal;
- 2.2.20. Tavolinë për vizita gjinekologjike me reflektor;
- 2.2.21. Burim drite artificiale për ekzaminim;
- 2.2.22. Pajisja për marrjen e strishove vagjinale dhe cervikale;
- 2.2.23. Pajisjen për anestezion lokal;
- 2.2.24. Fetoskop;
- 2.2.25. Komplet të uro-kateterave me dimensione të ndryshme për një përdorim;

---

<sup>11</sup>Është edhe të Pajisjet e përgjithshme të Ambulancës së burgut

<sup>12</sup>Është edhe të Pajisjet e përgjithshme të Ambulancës së burgut

<sup>13</sup>Është edhe të Pajisjet e përgjithshme të Ambulancës së burgut

<sup>14</sup>Është edhe të Pajisjet e përgjithshme të Ambulancës së burgut

<sup>15</sup>Është edhe të Pajisjet e përgjithshme të Ambulancës së burgut

- 2.2.26. Pajisje për marrjen e PAP-testi dhe përcaktimit të shkallës së pastërtisë;
- 2.2.27. Pajisjet për fiksion dhe dërgim në citologji\*
- 2.2.28. Pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike, hematologjike, biokimike dhe mikrobiologjike me sistem të mbyllur.
- 2.2.29. Ultrazëri

### **III. STACIONARI I BURGUT**

4.1. Stacionari i burgut duhet të përmbajë Ambulancën e burgut, dhe këto shërbime konsultative:

#### **3.1. SHËRBIMI SPECIALISTIK ISËMUNDJEVE TË BRENDSHME DHE KARDIOLOGJISË**

**Pajisjet:**

1. EKG;
2. Defribilator;
3. Echocardioplek\*
4. *Ergometria dhe Holterat nuk mund të jenë sepse kërkojnë kujdes 24 ore nga specialisti*

#### **3.2. SHËRBIMI SPECIALISTIK I ORTOPEDISË**

**Pajisjet:**

1. Kompletet me instrumente kirurgjike për kryerjen e intervenimeve të vogla kirurgjike-ortopedike vetëm nën anestezi lokal;
2. Tavolina për intervenime të vogla kirurgjike;
3. Pajisjen për anestezi lokal;
4. Pajisjen për matjet ortopedike;
5. Pajisjet për bllokadë lokale;
6. Pajisjen për vendosjen dhe largimin e gipsit;

#### **3.3. SHËRBIMI SPECIALISTIK I OTORINOLARINGOLOGJISË**

**Pajisjet:**

1. Kompletet e instrumenteve për ORL-së;
2. Kompletet me instrumente kirurgjike për kryerjen e intervenimeve të vogla kirurgjike në lëmin e ORL-së vetëm nën anestezi lokal;
3. Tavolina për intervenime të vogla kirurgjike;
4. Pajisjen për anestezi lokal;
5. Inhalator;
6. Mbajtësin e gjuhës;

7. Spekulum i për zgavrat e hundës;
8. Shiringën apo aparatën për shpëlarjen e veshëve;
9. Aspirator;
10. Pajisja për marrjen e strishos së hundës, veshit, fytit;
11. Piruni akustik;
12. Pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike.

### **3.4. SHËRBIMI SPECIALISTIK I PULMOLOGJISË**

#### **Pajisjet:**

1. Aspiratorin;
2. Pajisjen për punksion torakal dhe drenazh<sup>16</sup>;
3. *Spirometrin*;
4. Inhalator;
5. Kompresat;
6. Pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike, hematologjie, biokimike dhe mikrobiologjike me sistem të mbyllur;

### **3.5. SHËRBIMI SPECIALISTIK RADIOLOGJIK**

#### **3.5.1. Kushtet e Përgjithshme:**

1. Hapësira ku aplikohen rrezet jonizuese muret, tavani dhe dyshemeja duhet të jenë të mbështjella me folie plumbi, llaçit të bariumit, tulla të baritit apo betoni me trashësi adekuate që të mos lëshoj dozat absorbuese të rrezatimit jonizues më të lartë se 0,02mGy, ose dozat ekuivalente më të mëdha se 0,02mSv,
2. Dyert dhe dritaret duhet të jenë të mbuluara me plumb ose xham plumbi sipas intensitetit dhe energjisë së burimit.
3. Dyert e kabinave duhet të jenë të mbuluara me folie plumbi sipas intensitetit të burimit
4. Personeli është i obliguar që gjatë punës në zonën e rrezatimit të mbajë mjete mbrojtëse, përparëse syze, dorëza plumbi që kanë koeficient së paku 0.5 mm Pb ose që kanë koeficient të përbërjes së Pb konform intensitetit dhe energjisë së burimit.
5. Çdo i punësuar është i obliguar të mbajë dozimetrimin personal.
6. Dozimetri duhet të vendoset në gjoks apo krahë.

#### **3.5.2. Hapësira:**

1. Hapësirë në të cilën është i vendosur aparati i rëntgenit me një gyp duhet të ketë sipërfaqe prej së paku 20 m<sup>2</sup>
2. Hapësira për tabelën komanduese 4m<sup>2</sup>,
3. Hapësirë për zhveshjen e pacientëve
4. Hapësirë për zhvillimin e filmave

#### **3.5.3. Pajisje:**

---

<sup>16</sup> Edhe pse ky shërbim kryhet vetëm në spitale të përgjithshme (të jenë rezerve në rast nevojë ose mungesë në SP).

1. RTG aparati
2. RTG aparati për stomatologji
3. Doreza
4. Përparësen e Plumbit
5. Syza
6. Dozimetra
7. Tavoline për ekzaminim rëntgenologjik
8. Ulëse për ekzaminim rëntgenologjik
9. Ndarëse te plumbit

### **3.6. SHËRBIMI SPECIALISTIK I UROLOGJISË**

#### **Pajisjet:**

1. Kompletit me instrumente kirurgjike për kryerjen e intervenimeve të vogla kirurgjike-urologjike vetëm nën anestezion lokal;
2. Tavolina për intervenime të vogla kirurgjike;
3. Pajisjen për anestezion lokal;
4. Pajisja për punkcionin e fshikëzës urinare, cistofix
5. Komplet të uro-katetrave me dimensione të ndryshme për një përdorim;
6. *Cistoskop;*
7. *Dilatator;*
8. Pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike, hematologjike, biokimike dhe mikrobiologjike, me sistem të mbyllur.

### **3.7. SHËRBIMI SPECIALISTIK I FIZIATRISË ME TERAPI FIZIKALE**

#### **1. Hapësira:**

Hapësirën për ushtrimin e veprimtarisë së terapisë fizikale prej së paku 20m<sup>2</sup>, ashtu që gjatësia dhe gjerësia të mos jenë më pak se 4 m<sup>2</sup> apo numër të mjaftueshëm të hapësirave për forma të ndryshme të terapisë fizikale (kineziterapi, elektroterapi, masazh manuale), ku secila prej tyre nuk mund të jetë më e vogël se 9m<sup>2</sup> (ashtu që gjatësia dhe gjerësia të mos jenë më pak se 3 m<sup>2</sup>) me hapësirë të ndarë për përgatitjen e pacientit dhe vendosjen e gardërobës së tij;

#### **2. Pajisja:**

1. Çekanin;
2. Metri;
3. Këndmatësi;
4. Dinamometri;
5. Libela;
6. Lavjerrësi;
7. Pajisjen për punkcion dhe bllokadë lokale;
8. Shtrat për ekzaminim;
9. Tavolinën për pacient dhe shtratin për pacient;

10. Pajisjen për gjimnastikë mjekësore dhe kineziterapi, (*dyshek për ushtrime, shkallët suedeze, pasqyrën, pajisje për vet kujdes, shtrati për kineziterapi, korniza për suspenzion e vendosur mbi shtrat, jastëk, rrafshina të pjerrëta, kinetik, topa të gomës, dinamometër, trakë elastike*);
11. Pajisja dhe aparatura për elektroterapi (*aparati polivalent për elektroterapi*), *pajisja për termoterapi, ultrazëri terapeutik, pajisja për matje për punën e fizioterapeutit (dinamometri, metri, goniometër)*.

### 3. Pajisja për terapi të punës:

1. Pajisja didaktike;
2. Lodrat;
3. Pllaka me pajisje për ushtrimin e aktiviteteve të jetës së përditshme;

### 4. Pajisje të tjera:

1. Aparat për terapi me ultrazë;
2. Daitron-aparate;
3. Elektrostimulues;
4. Aparate për përdorim të rrymave interference;
5. Lampa rrezatimi ultraviolete dhe infra të kuqe;
6. *Peshëngritje;*
7. *Pesha;*
8. *Pasqyra;*
9. *Biçikleta.*<sup>17</sup>

## **3.8. SHËRBIMI SPECIALISTIK I OFTALMOLOGJISË**

### **Pajisjet:**

1. Tabelën për testimin e mprehtësisë së të pamurit dhe dallimin e ngjyrave;
2. Oftalmoskop;
3. *Aparatin për matjen e dioptrisë*
4. Thjerrëzën zmadhuese;
5. Pajisjen për shpëlarjen e syrit;
6. Tavolina për intervenime të vogla kirurgjike.

## **3.9. LABORATORI I STACIONARIT TE BURGUT**

### **5.1. Hapësira:**

- 5.1.1 Pritorën prej së paku 9m<sup>2</sup>;
- 5.1.2. Hapësirën për pranimin e pacientëve dhe marrjen e materialit prej së paku 12m<sup>2</sup>
- 5.1.3. Hapësira e punës për analiza laboratorike prej së paku 25m<sup>2</sup>;
- 5.1.4. Hapësirën për punë administrative dhe personel prej së paku 6m<sup>2</sup>.

### **5.2. Pajisja:**

---

<sup>17</sup>4 ( 6-9) gjenden ne burgje ne gjim

- 5.2.2. Garnitura e mobilieve laboratorike;
- 5.2.3. Karrige për pacientin dhe shtrati për marrjen e materialit;
- 5.2.4. Sterilizatori;
- 5.2.5. Frigoriferi;
- 5.2.6. Termostati;
- 5.2.7. Mikroskopi;
- 5.2.8. Centrifugat laboratorike;

### **5.3. Pajisja specifike e Labororit Mjekësor Biokimik-Hematologjik:**

- 5.3.2. Numëruesi hematologjik (8-18 parametra);
- 5.3.3. Spektrofotometri (340-700nm);
- 5.3.4. Banjë ujore;
- 5.3.5. *Lista shtese ne listën e barërave*<sup>18</sup>

## **3.10. SHËRBIMI I URGJENCËS**<sup>19</sup>

### **Pajisjet:**

1. Defibrilatori
2. EKG
3. Monitori për parametra
4. Oksigjen bombola
5. Stetoskop
6. Tensimetër
7. Anti shok terapia
8. Shtrati
9. Aspiratori
10. Pulsoksimetri
11. Kapëset për ndalje te gjakut
12. Ambumask

## **3.11. SHËRBIMET SHTESE**<sup>20</sup>

### **3.11.1. SHËRBIMIN SPECIALISTIK TE NEUROLOGJISË**

#### **Pajisje:**

1. Çekani për reflekse;
2. Gjilpërën për testim;

<sup>18</sup> Kjo listë i është bashkangjitur listës se bareve qe përpos këtyre pajisjeve ka dhe pajisje dhe material shtesë

<sup>19</sup> Shërbim i cili behet vetëm ne Stacionaret e burgjeve (2)

<sup>20</sup> Shërbime qe janë shtuar sipas nevojave dhe qe mund te hiqen ose shtohen te tjera varësisht nga indiukacionet

### **3.11.2. SHËRBIMIN SPECIALISTIK KIRURGJIK**

#### **Pajisjet:**

1. Kompleti me instrumente kirurgjike për kryerjen e intervenimeve kirurgjike vetëm me anestezi lokal;
2. Tavolina për intervenime të vogla kirurgjike;
3. Sonda;
4. Kateter;
5. Pajisje për punkcion;
6. Pajisje për bllokadë lokale;
7. Pajisje për anestezi lokal;
8. Aspirator;
9. Mbajtësin e gjuhës;
10. Mbajtësin e infuzionit;
11. Pajisje për marrjen e materialit për analiza citologjike, hematologjike, biokimike dhe mikrobiologjike, me sistem të mbyllur.
13. Canila
14. Fasha
15. Gips
16. Pajisje të tjera sipas nevojës.

### **3.11.3. SHËRBIMET E TJERA SHITESË, SUPLEMENTARE SPECILASITIKE DHE SUBSPECIALISTIKE**

Te gjitha shërbimet e tjera suplementare specialistike dhe subspecialistike, që nuk mund të kryhen në kuadër të Shërbimit Shëndetësor të Burgjeve bazuar në nivelet shëndetësore të vendit dhe mënyrës së referimit, referohen për institucione të tjera shëndetësore publike dhe private sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

### **3.11.4. AUTOAMBULANCA**

Te tri stacionaret duhet të kenë autoambulance përcjellëse.

Ka dy forma të posedimit të autoambulancave:

- a. Blerje nga MD ose nga donacion MSh, e të cilat duhet të menaxhohen nga ShKK/MD për shkaqe të sigurisë dhe sipas MM për transfer.
- b. Të jenë të huazuara, kontraktuara apo në shërbim nga njësitë e emergjencave të regjionit ku i takon stacionari për nevojat e caktuara.